



Lenda: Kërkesë për Informim
Për: Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Shtetit për Rindërtim
CC: Koordinator për të Drejtën e Informimit;
Nga: AIS / Open Data Albania

E/I nderuar Koordinator për të Drejtën e Informimit,

AIS, organizatë jo qeveritare, promotore e Open Data Albania, duke shprehur konsideratë për institucionin dhe punën tuaj, dhe duke vlerësuar nevojën për transparencë dhe integritet në menaxhimin e fondeve dhe kontraktimet publike, lutet të bëni të qartë Informacion më të plotë në lidhje me Shoqërinë e Biznesit që është Palë në Marrëveshjen e Lidhur me Shtetin Shqiptar.

Konkretisht: Marrëveshja Për Prodhimin dhe Furnizimin nga dhe Ndërmjet Pfizer Overseas LLC dhe Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe Ministrisë të Shtetit të Rindërtimit, e miratuar me Akt Normativ datë 16 Qershor 2021. Ky akt Miraton tekstin e marrëveshjes duke e parashikuar Nenin 1 pika 2, që kjo marrëveshje për shkak të sekretit tregtar dhe kërkesës së Kontraktorit nuk duhet të publikohet.

Në kërkimin tonë nuk po kërkojmë të dhëna dhe pjesë të tekstit të marrëveshjes dhe të sekretit tregtar. **Kërkimi ynë është për të dhëna më të qarta të Kompanisë Palë në Marrëveshje si Numër Identifikimi, Seli apo Regjistër Tregtar ku është regjistruar.** Emri i shoqërisë pa numër identifikimi dhe seli është përmendur në Aktin Normativ. Duke qenë se me emrin që Qeveria ka prezantuar në Akt Normativ funksionojnë më shumë se një shoqëri, me regjistrim në shtete të ndryshme të Amerikës, kërkimi ynë tenton thjesht një informacion më identifikues të Partnerit në Kontratë.

Kjo kërkesë vjen në kuadër të të Ligjit dhe të Drejtës për Informim, synon akses në të dhëna mbi Kontraktorin dhe jo mbi pjesë të marrëveshjes që Qeveria i ka konsideruar me Akt Normativ si sekrete tregtare.

Informacionin mund të na e përcillni në adresën tonë të emailit info@ais.al ose në adresën postare të shënuar më poshtë.

Me respekt

Aranita BRAHAJ
Drejtoresha Ekzekutive
Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS)
Adresë postare:
Rr "Asim Vokshi"
Pallati 13/25 Kati 3
Tiranë.
Tel 0682001718
Email: aranita.brahaj@ais.al